



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI

Nr. 187/prot
4

Koplik më: 7/5/2022

V E N D I M

Nr 6 datë 28 / 02 / 2022

PËR

1. "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Nik Skaqaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Nik Skaqaj nga programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr 70 datë 29.12.2022 "për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afat mesem 2022-2024 të Bashkisë Malësi e Madhe".

Baza Ligjore

Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Vendosi;

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit z. Nik Skaqaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit,.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për demtimin e banesë nga rënia e zjarrit.
3. T'i akordojë familjes së shtetasit Z. Nik Skaqaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, dhënie e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vlerën/shumen 100.000 (njëqind mijë) lekë, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr.70, datë, 29.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Malësi e Madhe", nga fondi i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe, nga Programi "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280".
4. T'i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetasit Z. Nik Skaqaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
5. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Z. Nik Skaqaj, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.

6. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit **Z. Nik Skaqaj**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.

7. Vlera e dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është 276.500 (dyqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë e peseqind) leke.

Dëmtime nga ana ndërtimore janë në vlerën 317.572 (treqind e shtembëdhjetë mijë e peseqind e shtatedhjetë e dy)

Vlera në total e dëmeve është : 594.072 (peseqind e nentëdhjetë e katër mijë e shtatedhjetë e dy) leke.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj



Miratuar me 28.02.2022

Vota Pro 22

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 04.03.2022